V E N D I M
Nr.62, datë 11.2.1999

PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT DHE TË LIKUIDIMIT NË NDËRMARRJET E SISTEMIT TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private", të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shlyerja e detyrimeve financiare, të realizuara nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.666, datë 26.10.1998 "Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore", të arkëtohet në favor të drejtorive të bujqësisë dhe ushqimit të rretheve përkatëse dhe të përdoret në destinacionin dhe sipas kushteve, si vijon:

a) Paguhen pagat e punonjësve, kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shpenzimet e tjera për ndërmarrjet në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të cilat ndodhen në proces privatizimi e likuidimi. Efektet financiare shtrihen që nga data 1.7.1997 e në vazhdim.

b) Me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit mund të bëhet transferim fondesh financiare ndërmjet drejtorive të bujqësisë dhe ushqimit në rrethe. Diferenca, që rezulton pas kryerjes së pagesave sipas pikës "a", kalon në favor të buxhetit të shtetit.

2. Brenda dy muajve pas miratimit të këtij vendimi, të pakësohet mbi 50 për qind numri i punonjësve të ndërmarrjeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të cilat ndodhen në proces privatizimi dhe likuidimi. Brenda datës 30.6.1999, t'u ndërpriten marrëdhëniet e punës të gjithë punonjësve të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të ish-komplekseve blegtorale. Pas kësaj date, ndjekja e arkëtimit të detyrimeve financiare nga debitorët privatë të realizohet nga drejtoritë e bujqësisë dhe të ushqimit në rrethe.

3. Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohen 20 milionë lekë për përballimin e shpenzimeve fillestare financiare.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, brenda 30 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, të dërgojë në Ministrinë e Financave, çdo muaj grafikun e arkëtimit të detyrimeve financiare nga debitorët privatë. Gjithashtu në çdo dy muaj të njoftojë Ministrinë e Financave për realizimin e grafikut të arkëtimeve.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko